

**TESTI PROFESIONAL  
E DREJTA PENALE  
Teza 8**

**1. Shprehuni lidhur me konceptin:**

**Neni 79, vrasja në rrethana të tjera cilësuese përmban germën “dh” “kundër dy ose më shumë personave”. Demonstroni si do ta zbatoni në praktikë gjithë problematikën e sjellë nga kjo dispozitë.  
(9 pikë)**

Gjatë aplikimit në praktik të germës “dh” “kundër dy ose më shumë personave” të nenit 79 të Kodit Penal janë evidentuar disa problematika lidhur me anën subjektive të kësaj vepre penale, format e fajit që ajo përfshin, si dhe çështja e kualifikimit ligjor nëse njëri, ose më shumë persona kanë cilësi të posaçme (i mitur, mangësi fizike, motivi i gjakmarrjes, marrëdhëniet familjare, funksionar publik, punonjësi i Policisë së Shtetit).


Në jurisprudencë<sup>1</sup> ka qëndrime se neni 79 i Kodit Penal, në lidhje me ardhjen e pasojës, për të gjitha rastet e parashikuara, me përjashtim të shkronjës “e”, “në mënyrë të rrezikshme për jetën e shumë personave” kërkon dashjen direkte të subjektit që kryen veprën penale. Në rastin e shkronjës “e” kjo dashje direkte lidhet me veprimin, anën objektive të veprës penale, ndërkohë që pasojat edhe pse mund të mos jenë të gjitha të dëshiruara nga subjekti, pra vijnë në mënyrë indirekte, nuk kanë rëndësi për ekzistencën e kësaj vepre penale. Pra ligjvënësi këtë rast, mjafton që vepra të jetë kryer me rrezikshmëri në dëm të shumë personave, e konsideron atë të cilësuar sipas nenit 79 të Kodit Penal, pavarësisht nëse lidhur me pasojat subjekti i veprës penale ka pasur dashje direkte apo jo.

Sipas këtij qëndrimi rrethana cilësuese “kundër dy ose më shumë personave”, lidhet ngushtësisht me anën subjektive të pandehurit, dashjen e tij direkte për të drejtuar sulmin kundër dy ose më shumë personave. Në këtë kuptim rezulton se kualifikimi i veprës penale sipas shkronjës “dh” të nenit 79 të KP-së.

Pavarësisht këtij qëndrimi në nenin 79 të Kodit Penal parashikohet shprehimisht se vepra penale kryhet me dashje, e cila mund të jetë e drejtpërdrejtë (direkte) ose e tërthortë (eventuale), e cila përfshin të gjitha rrethanat cilësuese të parashikuara në këtë nen. Rrethana cilësuese “dh” konsiderohet se është kryer në rastet kur autori me dashje ka privuar nga jeta dy apo më shumë persona. Kjo lloj vrasjeje mund të kryhet vetëm me dashje (direkte/indirekte), dhe vrasjet nga pakujdesia nuk mund të kualifikohen sipas kësaj dispozite. Vrasja e tillë konsiderohet se është kryer nëse autori dy apo më shumë vrasje i kryen në bashkimin ideal apo real, në të njëjtën kohë, ose shumë të afërt. Kjo formë e vrasjes në rrethanën “dh” do të konsiderohet se ekziston edhe në rastet kur është tentuar vrasje e dy apo më shumë personave, apo kemi një vrasje të një personi, ndërsa tentative për tjetrin.

Lidhur me subjektin, rrethana cilësuese “kundër dy apo më shumë personave” u referohet subjekteve që nuk kanë cilësi që i kategorizon si subjekte të posaçëm, si dhe vrasjeve jo me motiv gjakmarrje, apo të kryerja me paramendim për interes, apo hakmarrje. Nëse do të kemi vrasjen e një subjekti të posaçëm dhe një subjekti të zakonshëm, apo dy subjekteve të posaçëm, apo një vrasje me motiv gjakmarrje, apo më shumë të tilla, atëherë nuk jemi përpara nenit 79, shkronja “dh” të Kodit Penal, por për secilin subjekt do të bëhet cilësimi i faktit penal më vete, sipas neneve përkatëse, në konkurrim ndërmjet tyre.

<sup>1</sup> Vendimet e KPGJL-së nr. 173, datë 9.7.2024; nr. 177, datë 29.5.2013; nr. 79, datë 27.4.2016.



**2. Bëni krahasimin ndërmjet veprave penale të parashikuara në Kodin Penal, neni 230 (terrorizmi) dhe neni 111 (rrëmbimi i avionëve)? (10 pikë)**

Figura e veprës penale “Rrëmbimi i avionëve, anijeve dhe mjeteve të tjera” (neni 211 i KP-së), ka disa ngjashmëri me figurën e veprës penale “Vepra me qëllime terroriste”, të cilat kryesisht qëndrojnë lidhur me anën objektive. Për shkak të teknikës legislative krijohet konfuzion lidhur me mëvetësinë e këtyre dy figurave të veprave penale, sepse në përshkrimin e teknikave të inkriminimit, neni 230 i KP-së, e konsideron rrëmbimin e avionëve, të anijeve, të mjeteve të tjera të transportit apo të platformave fikse ose ushtrimin e paligjshëm të kontrollit mbi to, me dhunë ose nëpërmjet kanosjes për përdorimin e dhunës apo me anë të çdo forme tjetër kanosjeje, *kur kryhet me qëllim përhapjen e panikut në popullatë ose për të detyruar organe shtetërore, shqiptare ose të huaja, të kryejnë ose të mos kryejnë një akt të caktuar, ose për të shkatërruar apo destabilizuar, në mënyrë serioze, struktura thelbësore politike, kushtetuese, ekonomike ose sociale të shtetit shqiptar, të një shteti tjetër, institucioni apo organizate ndërkombëtare, si vepër me qëllime terroriste.*

Megjithatë këto dy figura paraqesin dallime thelbësore ndërmjet tyre, lidhur me të gjithë elementet e tyre, objektin, anën objektive, subjekti, ana subjektive. Rrëmbimi i avionëve është vendosur në **Kreun II, Seksion VII, të pjesës së parë** të Kodit Penal, titulluar “Vepra penale kundër lirisë së personit” me objekt grupor, të mirën juridike, sigurimin e lirisë së personit, ndërsa terrorizmi është vendosur në **Kreun VII**, titulluar “Vepra me qëllime terroriste” me objekt grupor, të mirat juridike siguria kombëtare, sigurimin e jetës, shëndetit, të pronësishë etj.

Objekti i drejtpërdrejtë (multiofensiv) i rrëmbimit të avionëve janë të mirat juridike garantimi i qarkullimit të lirë të njerëzve, jeta, shëndeti dhe pasuria e tyre, të cilët cenohen nga zotërimi dhe vënia nën kontroll të tyre. Ndërsa objekti i drejtpërdrejtë i terrorizmit janë të mirat juridike, si: jeta, shëndeti i njerëzve, liria personale e tyre, pronës publike, sistemit të transportit, të informacionit, mjedisit, të rendit publik, rrëmbimit të avionëve, anijeve, prodhimit, tregutit të lëndëve shpërthyes etj.

Nga ana objektive terrorizmi, përveç rrëmbimit përfshin edhe kryerjen e veprave të tjera si veprat kundër jetës, shëndetit të personave, kryerja e akteve të dhunës, pengmarrjen, shkatërrimin ose dëmtimin e rëndë të mjediseve etj.

Ana subjektive e figurës së veprës penale të terrorizmit përbën elementin thelbësor dallues me figurat e tjera të veprave penale, të cilat janë tipologji të kryerjes së saj, forma të kryerjes së saj si vrasjet, plagosjet e rënda, rrëmbimet, shkatërrimet e pronës etj., të cilat qëndrojnë më vetë, të parashikuara nga dispozitat përkatëse të kodit penal, por nëse kryerja e tyre bëhet me dashje të drejtpërdrejtë me qëllim përhapjen e panikut në popullatë ose për të detyruar organe shtetërore, shqiptare ose të huaja, të kryejnë ose të mos kryejnë një akt të caktuar, ose për të shkatërruar apo destabilizuar, në mënyrë serioze, struktura thelbësore politike, kushtetuese, ekonomike ose sociale të shtetit shqiptar, të një shteti tjetër, institucioni apo organizate ndërkombëtare, ato konsiderohet vepra terroriste dhe kualifikimi ligjor sipas konkurrit formal heterogjen, duhet të bëhet sipas nenit 230 të KP-së.

Rrëmbimi i avionëve, anijeve dhe mjeteve të tjera të transportit ku ndodhen njerëz, mund të konsiderohet si zotërimi, ose vënia nën kontroll i një avioni, në mënyrë të tillë që autori e drejton personalisht, ose lëshon urdhra duke e drejtuar atë, e cila është gjithmonë është e shoqëruar me kërcënime, forcë, dhunë, armë etj., dhe kryhet me dashje direkte, për qëllime të ndryshme, të dallueshme nga qëllimi terrorist i përmendur më sipër.

**3. Argumentoni në përgjigjen tuaj të gjitha arsyet nëse kryerja e falsifikimit të dokumentit zyrtar nga persona që kanë detyrë ta lëshojnë atë, me ndihmën, apo kërkesën e personave jo të tillë, por që u duhet për ta përdorur, do të**



**kualifikohet sipas së njëjtës dispozitë penale apo jo? Çfarë rëndësie merr dispozita e posaçme në këtë rast dhe a ndikon ajo në bashkëpunimin e personave? (15 pikë)**

Referuar praktikës unifikuese të Gjykatës së Lartë (vendimit nr. 3/2025), kur vepra penale kryhet në bashkëpunim në formën bashkëekzekutimit, si rregull, të gjithë bashkëpunëtorët do të përgjigjen për të "njëjtën vepër penale" të parashikuar nga e njëjta dispozitë e Pjesës së Posaçme të Kodit Penal. Në rastin e personave të tjerë të përgjithshëm (extraneus) që nuk mbajnë cilësitë e veçanta apo nuk kanë pozitën subjektive të personit të cilësuar në veprën penale dhe që bashkëpunojnë me subjektin e cilësuar, të gjithë bashkëpunëtorët, qofshin ata të cilësuar apo të përgjithshëm, do të përgjigjen për të njëjtën vepër penale, vetëm kur personat e përgjithshëm bashkëpunëtorë që nuk janë të cilësuar (extraneus) janë të vetëdijshëm, duke pasur dijeninë në lidhje me cilësitë apo pozitën subjektive të personave të cilësuar dhe kjo cilësi e tyre ka lehtësuar bashkëpunimin për kryerjen e veprës penale të përbashkët. Pra, nëse personat e tjerë nga ata që janë të cilësuar, kanë anën subjektive lidhur me cilësinë e veçantë të personit të veprës penale, qoftë në formën e pakujdesisë, ku personi duhet dhe mund ta kishte parashikuar rrethanën e cilësisë së veçantë të personit të veçantë, qoftë në formën e dashjes, të dy këto kategori bashkëpunëtorësh do të përgjigjen për të njëjtën vepër penale. Në kushtet kur vepra penale e falsifikimit të dokumentit nuk do të kryhej pa kërkesën e personit, kërkesë e cila merr trajtën e nxitjes, apo ndihmës së personit që i duhet dokumenti për përdorim, atëherë jemi përpara bashkëpunimit midis personit zyrtar që ka për detyrë të lëshojë dokumentin dhe personit që i duhet dokumenti për përdorim. Edhe pse jemi në kushtet e bashkëpunimit dhe kryerja e veprës penale në bashkëpunim parashikohet në mënyrë të shprehur si rrethanë cilësuese në nenin 186/2 të Kodit Penal, fakti nuk do të kualifikohet sipas nenit 186/2 të Kodit Penal. Kjo për arsye se në këtë mënyrë nuk merret në konsideratë cilësia e posaçme e njërit prej subjekteve në bashkëpunim, cilësi e cila bën që fakti penal të kualifikohet sipas paragrafit të tretë të nenit 186 të Kodit Penal. Duke qenë se në referim të praktikës unifikuese do të marrë rëndësi cilësia e posaçme e subjektit dhe edhe personi që nuk ka cilësi të posaçme do të përgjigjet po për të njëjtën veprën penale, atëherë fakti penal do të kualifikohet falsifikim i kryer sipas rrethanës cilësuese "kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin" në bashkëpunim sipas nenit 186/3 dhe 25 të Kodit Penal.

4. Neni 80 i Kodit Penal parashikon përgjegjësinë penale nëse personi siguron kushtet dhe mjetet materiale për të kryer vrasje. Analizoni situatën ku personi ka siguruar armë për të kryer veprën për të arritur konkluzionin nëse ai do të mbajë përgjegjësi penale për vrasje, armëmbajtje pa leje, apo sigurimin e kushteve për të kryer vrasje? Sa vepra penale konkurrojnë në këtë rast. (16 pikë).

Në rastin, në të cilin personi ka siguruar armë për të realizuar vrasjen dhe kjo e fundit ka ndodhur, për të arritur në përfundimin nëse ai do të mbajë përgjegjësi penale për vrasje, armëmbajtje pa leje, apo sigurimin e kushteve për të kryer vrasje, duhet të analizohet konkurrimi fiktiv në formën e subsidiaritetit.

Kolegjet e Bashkuara në vendimin unifikues nr. 3/2015 kanë definuar konkurrimin fiktiv të subsidiaritetit, i cili bazohet në praninë e një raporti funksional midis dy normave penale lidhur me mbrojtjen e një marrëdhënieje juridike që mbrohet në nivele të ndryshme cenimi apo formash të cenimit. Sipas këtij parimi, një normë kryesore ka përparësi, kur ajo e mbron në një nivel më lartë marrëdhënien juridike që mbrohet në një nivel më të ulët nga një normë dytësore. Pra, fakti penal i parashikuar sipas normës dytësore, plotëson dhe përthithet nga

fakti i parashikuar si vepër penale nga norma e kryesore, duke gjetur përparësi zbatimi i normës kryesore. Në këtë rast, konkurrimi i normave penale, zgjidhet në favor të normës kryesore. Prandaj, vetëm në rast se fakti që përbën veprën penale, nuk hyn në fushëzbatimin e normës kryesore do gjejë zbatim norma dytësore. Raporti i ndërveprimit në këtë rast, mund të konsiderohet si një raport hierarkik, ku njëra normë (kryesore) parashikon përparësinë e zbatimit të saj, në raport me normën tjetër (dytësore). Kjo e dyta, zbatohet vetëm kur nuk gjen zbatim norma e parë (kryesore). Sipas këtij parimi, zbatimi i njëres normë në të njëjtën kohë për të njëjtin fakt, përjashton zbatimin e normës penale tjetër, në rastin e mbrojtjes së marrëdhënieve juridike që mbrohen në mënyrë progresive dhe të përshkallëzuar nga një nivel më i ulët drejt një niveli më të lartë.

Parimi i subsidiaritetit ndërhyr për të mbuluar një hapësirë të lënë nga normë tjetër, apo kur dy a më shumë norma mbrojnë në shkallë të ndryshme marrëdhënien juridike. Baza për praninë e këtij parimi të përgjithshëm në Kodin Penal shqiptar gjendet edhe në parashikimin e klauzolave tipike ligjore: “kur (fakti) nuk përbën vepër tjetër penale”, si dhe në interpretimin e normës në raport me marrëdhënien juridike.

Në konkurrimin fiktiv të subsidiaritetit një vepër penale paraqitet si fazë paraprake e veprës penale të dytë. Pra, figurat e parashikuara nga nenë të ndryshme të K. Penal përfaqësojnë shkallë, faza të ndryshme të kryerjes së veprës penale (në të ashtuquajturin *rrugëtim kriminal*). Pra, ato përfaqësojnë shkallë të ndryshme të cenimit të së njëjtës të mirë juridike të mbrojtur nga legjislacioni penal.

Kështu në nenin 80 të K. Penal sanksionet se “sigurimi i kushteve dhe mjeteve materiale për të kryer vrasje...”. Nëse më pas ai realizon vrasjen e personit nuk mund të kemi konkurrim të veprave penale sepse “përgatitja për të kryer vrasjen” është fazë që e paraprin figurën e “vrasjes. Nëse do të aplikohet konkurrimi ndërmjet tyre, do të dënohet i njëjtin person dy herë për të njëjtën vepër penale, sepse vepra penale që përbën fazën e avancuar të cenimit të marrëdhënies juridike përkatëse, i përmban edhe elementat e figurës që përbën fazë të mëparshme. Vepra e dytë e “përfshin” të parën, si fazë finale e rrugëtimit kriminal.

Në këtë rast kemi konkurrim ligjesh në formën e subsidiaritetit pasi njëra vepër paraqitet plotësuese, aksesore, në raport me veprën tjetër. Vepra plotësuese do të gjejë zbatim vetëm nëse vepra që përfaqëson fazë më të avancuar nuk kryhet. (Lex primaria derogat legi supsidiare.) Subsidiariteti mund të jetë formal, në rastet që është vetë ligji penal parashikon shprehimisht se figura përkatëse do të zbatohet vetëm në rast se nuk përbën vepër tjetër penale. Subsidiariteti mund të jetë edhe material. Në këtë rast ekzistenca e marrëdhënies së subsidiaritetit ndërmjet veprave, përcaktohet mbi bazën e interpretimit të dispozitave ligjore, nisur nga njohurit e përgjithshme për veprën penale. Të tilla janë figurat që përbëjnë fazat e mëparshme të kryerjes së veprës, si përgatitja, apo tentativa për kryerjen e saj. Në Kodin Penal parashikohen vetëm dy figura që dënojnë përgatitjen për kryerjen e një vepre penale: “përgatitja për vrasje” (neni 80) dhe “përgatitja për vjedhje” (neni 142).

Nëse vrasja është realizuar, kualifikimi ligjor do të jetë për veprat penale të vrasjes dhe armëmbajtjes pa leje.

*Jlli J. Durrës*

## Teza 24

### PROCEDURE PENALE

#### I. Pyetje mbi koncepte (10 pikë)

**Cili është raporti që rregullon Kodi midis të drejtës së mbrojtjes së përbashkët dhe papajtueshmërisë së interesave, kur në proces janë të akuzuar dy ose më shumë të pandehur. Kush e konstaton dhe si zgjidhet kjo papajtueshmëri?**

Kur në proces janë akuzuar dy ose më shumë të pandehur, mbrojtja e interesave të dy ose më shumë prej tyre mund të merret përsipër nga i njëjti mbrojtës, por me kushtin që mes tyre të mos ketë papajtueshmëri interesash.

Papajtueshmëria e interesave nënkupton rastet kur interesi i mbrojtjes së një të pandehuri do të dëmtonte interesat e mbrojtjes së të pandehurit tjetër, fakt që do ta bënte të pamundur mbrojtjen e tyre nga i njëjti avokat.

Konstatimin e papajtueshmërisë e bën organi që procedon: prokurori në hetime paraprake dhe gjykata, në seancë paraprake ose gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes. Konstatimi mund të bëhet kryesisht ose pasi papajtueshmëria të jetë ngritur nga pala e interesuar.

Pas konstatimit, parimi i moscenimit të të drejtës së mbrojtjes kërkon që zgjidhjen ta gjejnë mbrojtësi me të pandehurit që ai mbron. Nëse një zgjidhje e tillë nuk gjendet prej tyre, prokurori ose gjykata ndërhyjnë me vendimin për zëvendësimin e mbrojtësit të zgjedhur nga i pandehuri (të pandehurit) me një (disa) mbrojtës të caktuar kryesisht.

#### II. Pyetje krahasuese (10 pikë)

**Bëni dallimin midis arrestimit në flagrancë dhe ndalimit të të dyshuarit për krim.**

Dallimet ndërmjet arrestimit në flagrancë dhe ndalimit të të dyshuarit për një krim, pasqyrohen në veçoritë e mëposhtme:


1- Gjendja në çastin e ndërhyrjes: arrestimi në flagrancë, sikundër e përkufizon ligjvënësi, lejohet vetëm kur autori vepron në kushtet e flagrancës së krimit; ndalimi ndaj të dyshuarit për kryerjen e një krimi kryhet gjithmonë jashtë rasteve të flagrancës së krimit, nuk lidhet me gjendjen e flagrancës të autorit, por vetëm me rrezikun e ikjes së tij për t'iu shmangur drejtësisë.

2- Organi që procedon: arrestimi në flagrancë është akt që kryhet nga policia gjyqësore dhe, në raste të veçanta, edhe nga shtetasit; ndalimi – kërkon urdhër nga prokurori, i cili ekzekutohet nga policia gjyqësore. Ndalimi nga policia gjyqësore me nismën e saj është rast përjashtimor: vetëm në raste të ngutshme, kur situata nuk lejon që të pritët një urdhër nga prokurori, ndalimi i të dyshuarit lejohet të kryhet nga policia gjyqësore.

3- Rëndësia e veprës penale: arrestimi në flagrancë të krimit, përveç veprave penale të kryera me dashje, lejohet edhe për vepra penale të kryera nga pakujdesia. Si përjashtim, lejohet edhe në rastin e kundërvajtjeve penale; ndalimi lejohet vetëm në rastin e krimeve të kryera me dashje, për të cilat KP parashikon një sanksion jo më të ulët në maksimum se 4 vjet.

#### III. Pyetje argumentuese (15 pikë)

**Vlerësoni rëndësinë e simulimit në rastin e krimit të korrupsionit pasiv.**



Kodi i Procedurës Penale lejon përdorimin e metodës së posaçme të simulimit të një akti korruptiv, në rastin kur kryhen hetime për krimin e korrupsionit. Kjo metodë parakupton një situatë të stisur, por të paraqitur si e vërtetë, me anën e së cilës synohet të realizohet një gjendje e flagrancës së krimit të korrupsionit dhe të sigurohen provat e fajësisë për autorin e dyshuar. Praktikisht, personit të dyshuar i premtohet ose i ofrohet një përfitim i paligjshëm, zakonisht në formë të hollash nga një OPGJ (ose nga një person i autorizuar prej tij) dhe pasi ai pranon t'i marrë ato, policia gjyqësore lejohet të ndërhyjë, për të sekuestruar provën e kryerjes së aktit korruptiv. Simulimi mund të shoqërohet edhe me regjistrimin zanor ose pamor të veprimit.

Akti i simulimit kryhet me autorizim dhe nën mbikëqyrjen e prokurorit. Kompetenca për të nënshkruar autorizimin i përket prokurorit që kryen hetime (ose prokurorit që ushtron funksionet në rrethin ku do të kryhet veprimi simulues). Veprimi simulues në terren kryhet nga oficeri i policisë gjyqësore ose nga një person tjetër, i autorizuar prej tij, që mund të jetë edhe një person privat.

E rëndësishme është shmangja e provokimit. Nuk lejohet që të simulohet një situatë korrupsioni pasiv, e cila nuk do të kishte ndodhur realisht, nëse nuk do të ishte stisur nga policia. Në një rast të tillë, prova e kryerjes së krimit të korrupsionit do të ishte e papërdorshme. Për këtë arsye, simulimi nëpërmjet ofrimit të një përfitimi të paligjshëm, duhet të përdoret pasi autoriteti që procedon të jetë bindur se akti korruptiv do të kishte ndodhur edhe sikur policia të kishte qëndruar pasive.

#### IV. Arsyetim analitik (15 pikë)

**Në seancë paraprake, mbrojtja ngriti pretendimin e pavlefshmerisë së një akti, kërkesë që iu rrëzua nga gjykata. Në vijim, i pandehuri paraqiti kërkesë për gjykim të shkurtuar. Argumentoni vendimin e gjyqtarit të seancës paraprake për kërkesën e fundit. Tregoni kriteret që duhet të ndjekë GJSP në vendimmarrjen e tij.**

Sipas nenit 332/c/3 të KPP, në seancë paraprake, i pandehuri ose mbrojtja e tij përveç kërkesës për pavlefshmërinë e akteve të hetimeve paraprake, etj., mund të paraqesin edhe kërkesë për t'u gjykuar sipas rregullave të gjykimit të shkurtuar.

Sipas nenit 405/7 të KPP, kërkesa për gjykim të shkurtuar nuk pranohet edhe në rastin kur i pandehuri apo mbrojtësi i tij ngrenë pretendime mbi vlefshmërinë e akteve të kryera gjatë hetimeve paraprake.


Çështja shtrohet në ç'raport qëndrojnë këto norma me njëra-tjetrën dhe nëse pretendimi fillestar për pavlefshmëri të akteve do të pamundësonte automatikisht pranimin e një kërkesë për të proceduar me gjykim të shkurtuar?

Si rregull, ndër detyrat e GJSP-së është edhe vlerësimi i vlefshmërisë së akteve, me qëllim korrigjimin e pavlefshmërive, kur ky veprim është i mundshëm. Në këtë rast, kërkesa për pavlefshmëri është rrëzuar nga gjykata, fakt që nënkupton se ky pretendim nuk ka qenë i mbështetur. Në këto rrethana, nuk ka pasur arsye pse të pandehurit t'i rrëzohet automatikisht kërkesa për gjykim të shkurtuar.

Kriteret bazë që duhet të ndjekë GJSP-ja për pranimin ose jo të kërkesës për gjykim të shkurtuar, duhet të përmbledhen në dy pyetje:


(i) hetimet e kryera janë të plota?

(ii) nëse hetimet janë të plota, a mund të zgjidhet çështja në gjendjen e akteve të përfshira në fashikullin e paraqitur nga prokurori apo për të zgjidhur çështjen është e domosdoshme që të ketë një shqyrtim gjyqësor me debat?



Në këtë kuptim, GJSP-ja, pa hyrë në themelin e fajësisë/pafajësisë së të pandehurit, duhet të vlerësojë provat në aspektin e mjaftueshmërisë e tyre dhe nëse një debat gjyqësor mbi vlerën dhe fuqinë provuese të tyre do të ishte i domosdoshëm ose jo. Nëse GJSP-ja, nga gjendja e akteve në fashikullin e prokurorit, bindet se çështja nuk mund të zgjidhet drejt pa u kryer një debat gjyqësor, e rrëzon kërkesën për gjykim të shkurtuar. Në rast të kundërt – e pranon atë, pavarësisht kërkesës fillestare të mbrojtjes për pavlefshmëri, tashmë të rrëzuar.<sup>1</sup>

Henrik Gijepi  
Hannu



---

<sup>1</sup> Në vlerësimin e kësaj rubrike, varësisht nga arsyetimi i kandidatit, do të merret në konsideratë fakti se në praktikën gjyqësore jashtë shfaqur edhe zgjidhje të ndryshme nga ai i argumentuar në çelsin e përgjigjes.



# TESTI PROFESIONAL

## E DREJTË CIVILE

### TEZA 16

#### 1. Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme:

##### a. Cilat janë detyrimet e qiramarrësit:

1. të marrë në dorëzim sendin dhe ta përdorë për qëllimin që është parashikuar në kontratë dhe, kur nuk është parashikuar në kontratë, sipas qëllimit që del nga natyra e sendit;
3. të kryejë pagesën në afatet e caktuara;
3. t'ia kthejë sendin qiradhënësit në të njëjtën gjendje që e ka marrë;
4. të mirëmbajë sendin;
5. të mbulojë shpenzimet e zakonshme e të përditshme që dalin gjatë përdorimit.

##### b. Me cilat mënyra bëhet dorëzimi i sendeve që janë objekt detyrimi?

Dorëzimi i sendeve bëhet sipas mënyrës së caktuar në kontratë dhe kur kjo nuk është caktuar bëhet:

- a) me dhënien e tyre në dorë personit që ka fituar pronësinë e tyre ose personit që heq të drejta prej tij;
- b) me dhënien transportuesit ose postës për t'ia dorëzuar fituesit, në vendin e treguar prej tij;
- c) me dhënien fituesit në dorë ose dërgim nëpërmjet postës të dokumenteve (fletë ngarkese, dëshmi depozitimi) që i japin të drejtën e disponimit të mallit ose sendit. (Shih nenin 458 të Kodit Civil.)

##### c. Cilat janë mënyrat e shuarjes së servituteve?

1. Kur në një person të vetëm bashkohet pronësia e pronës mbizotëruese me atë të pronës shërbyese.
2. Parashkruhet; kur nuk përdoret për më shumë se dhjetë vjet.
3. Kur sendet dëmtohen ose konsumohen deri në një shkallë sa nuk mund të përdoren për qëllimin e tyre. (Shih nenin 293 të Kodit Civil.)

(10 pikë-3+2+5 pikë)

#### II. Shpjegoni ndryshimin e koncepteve apo instituteve të mëposhtme:

**Ku dallon heqja dorë nga trashëgimi nga heqja dorë nga pronësia?**

1. Në të dy rastet jemi para veprimit juridik të njëanshëm, por dallon lloji i marrëdhënies juridike/të drejtës që shuajnë; njëra të drejtën (marrëdhënien juridike) e pronësisë, ndërsa tjetra të drejtën (marrëdhënien juridike) e trashëgimisë (ose shprehja e vullnetit për të mos kaluar te ai pasuria e personit të vdekur).
2. Nga e drejta e pronësisë që ka kaluar në çastin e vdekjes së trashëgimlënësit, hiqet dorë me efekt/mënyrë prapavepruese. Personi quhet se nuk është thirrur ndonjëherë në trashëgim. Ndërsa heqja dorë nga pronësia nuk ka efekt prapaveprues.
3. Heqja dorë nga pronësia është e pakushtëzuar me afate parashkrimi ose prekluziviteti dhe e drejta për të hequr dorë nuk humbet/shuhet, ndërsa nga trashëgimia mund të hiqet dorë vetëm brenda afateve prekluzive të parashikuara nga ligji dhe e drejta mund të humbasë në kushtet e parashikuara nga ligji (neni 338 i Kodit Civil).

(10 pikë)

#### III. Cili është kuptimi i padenjesisë dhe çfarë pasojash sjell ajo

Me institutin (konceptin) e "Padenjesisë", kuptohet sanksioni civil/ligjor, që ka për qëllim të përjashtojë nga trashëgimia ligjore ose testamentare, personin që ka mbajtur një qëndrim ose sjellje të padenjshme ndaj



trashëgimlënësit. I padenjë do të konsiderohet vetëm ai trashëgimtar, që ka kryer një ose më shumë sjellje cenuese, poshtëruese ose keqtrajtuese ndaj trashëgimlënësit ose të afërmeve të tij të përcaktuar në ligj. Sjellje të padenja do të konsiderohen vetëm ato të sanksionuara shprehimisht nga dispozita e ligjit (neni 322 i Kodit Civil). Konkretisht:

- ai që me dashje ka vrarë ose ka tentuar të vrasë trashëgimlënësin, bashkëshorten, fëmijët dhe prindërit e tij;
- ai që ka bërë ndaj trashëgimlënësit kallëzim ose dëshmi të rreme, për kryerjen e një veprë penale për të cilën parashikohet dënim me vdekje ose me heqje lirie mbi 10 vjet, kur kallëzimi ose dëshmia janë deklaruar të rremë në një gjykim penal;
- ai që me mashtrim, kanosje e dhunë ka shtyrë trashëgimlënësin që të bëjë, të ndryshojë ose të shfuqizojë testamentin ose ka përpiluar vetë një testament të rreme ose e ka përdorur atë për interesa të tij apo të të tjerëve;
- ai që është sjellë ndaj trashëgimlënësit në mënyrë poshtëruese dhe që e ka keqtrajtuar atë.

Pasojat që sjell padenjësia për personin që deklarohej i padenjë:

1. përjashtohet nga trashëgimia ligjore ose testamentare dhe zëvendësohet nga trashëgimtarët e tjerë sipas parashikimeve ligjore (neni 361, paragrafi i dytë i Kodit Civil); ose kur nuk ka persona që trashëgojnë me zëvendësim, pjesa që i takon atij u shpërndahet pjesëve të trashëgimtarëve të tjerë;
2. detyrohet të kthejë pasurinë që ka përfutur, frutat dhe çdo të ardhur tjetër që ka marrë nga pasuria në trashëgim pas çeljes së trashëgimisë.

(15 pikë)

#### IV. Analizoni situatën e mëposhtme dhe përgjigjuni pyetjeve të shtruara:

Mes Bankës X dhe shtetasit A është lidhur kontrata e kredisë bankare datë 4.5.2000, me objekt lëvrimin e kredisë në vlerën 20 000 euro, me afat ripagimi 3 vite. Detyrimi garantohej nga dorëzanësi B i cili ka lidhur kontratën e dorëzisë me bankën X.

Më datën 6.3.2001, me pëlqimin edhe të kreditorit Banka X, është realizuar zëvendësimi në marrëdhënien juridike të kredisë. Kredi marrësit A (debitori) me kredi marrësin e ri C. Për këtë zëvendësim të palëve dorëzanësi B nuk ka pasur asnjë dijeni (nuk është njoftuar).

Gjatë fazës së ekzekutimit të kontratës së kredisë bankare përmbaruesi ka ndërmarrë veprime edhe ndaj pasurisë së dorëzanësit B me qëllim ekzekutimin e detyrimit të debitorit C (kredi marrësi).

Këto veprime janë kundërshtuar gjyqësisht nga dorëzanësi konform nenit 610 të KPC-s.

#### Pyetje:

**Jepni përgjigjen tuaj të argumentuar nëse dorëzanësi B mund të garantojë ekzekutimin e detyrimit të kredi marrësit C kundrejt bankës X?**

Fillimisht duhet të evidentohet fakti se në rastin e "Zëvendësimit të debitorit", Kodi Civil i parashikon shprehimisht pasojat për mjetet që sigurojnë ekzekutimin e detyrimeve. Me fjalë të tjera, ligji rregullon shprehimisht pasojat përkatëse. (Shih nenin 496 të Kodit Civil.)

Në Kodin Civil, parashikohet se në rastin e zëvendësimit të debitorit, përveç pengut dhe hipotekës që mbeten në fuqi, garancitë e tjera të dhëna nga persona të tretë për detyrimin përkatës, shuhet, në rast se këta nuk kanë dhënë pëlqimin që ato të mbeten edhe për debitorin e ri (shih nenin 496, paragrafin e dytë të Kodit Civil); Pra, dorëzania mbetet në fuqi vetëm me pëlqimin e dorëzanësit.


Ligji kërkon pëlqimin e dorëzanësit si kusht për vazhdimin e marrëdhënies juridike të dorëzisë, pasi nga interpretimi sistematik dhe qëllimor (teleologjik) i dispozitave që rregullojnë këtë institut (dorëziminë), vlerësohet se subjekti dorëzanës garanton kreditorin për cilësitë personale të debitorit, për besueshmërinë dhe mundësinë e tij në përmbushjen e detyrimit. Gjithashtu dorëzanësi merr përsipër riskun duke garantuar ekzekutimin e detyrimit me pasurinë e tij, pa dhënë si garanci një pasuri të caktuar. Kjo karakteristikë e dallon dorëziminë nga mjetet reale të garancisë, si për shembull pengun apo

hipoteka, të cilat krijohen e janë të lidhura pazgjidhshmërisht me sendin dhe pasurinë respektive që individualizojnë palët në kontratë.

Në këtë rast, dorëzanësi i ka kundërshtuar veprimet përmbarimore në bazë të nenit 610 të K.Pr.Civile, pasi nuk ka dhënë pëlqimin për të garantuar debitorin e ri. **Rrjedhimisht dorëzania është shuar dhe dorëzanësi B nuk mund të detyrohet të garantojë ekzekutimin e detyrimit të debitorit C, kundrejt bankës X.**

**Shënim:**

Për pyetjet joriprodhuese vlerësohen: Struktura, rrjedhshmëria, terminologjia juridike e përdorur, arsyetimi ligjor e logjik dhe konkluzioni i drejtë.



## TESTI PROFESIONAL

### PROCEDURË CIVILE

#### TEZA 3

1. a- Nëse pala paraqet "filma fotografikë ose filma kinematografikë, kaseta të çdo lloji, si dhe çdo lloj tjetër regjistrimi" a mund të pranohen nga gjykata si provë për ngjarjet ose sendet që janë regjistruar në to? Nëse po, kur?

*Filmat fotografikë ose filmat kinematografikë, kaseta të çdo lloji, si dhe çdo lloj tjetër regjistrimi, mund të përbëjnë provë për ngjarjet e sendet që janë regjistruar, kur gjykata bindet për saktësinë e vërtetësinë e tyre. Për këtë qëllim ajo mund të thërrasë edhe ekspertë kompetentë. (neni 278)*

6 pikë

- b- Jepni përkufizimin sipas KPC kur një provë quhet fillim prove me shkrësë:

*Quhet fillim prove me shkrësë çdo shkrësë, që rrjedh nga ai, kundrejt të cilit drejtohet kërkimi dhe nga përmbajtja e së cilës del se fakti i pretenduar është pothuajse i vërtetë; (neni 233 "b")*

6 pikë

2. Shpjegoni cilat janë llojet e pohimit gjyqësor dhe jepni për secilin lloj dy shembuj, që i konkretizojnë ato në praktikë. Analizoni dallimin ndërmjet "pohimit gjyqësor" dhe "shpjegimeve të palës në procesin gjyqësor".

*Pohimet gjyqësore:*

- a. Pohimi gjyqësor i rastit, i cili mund të jetë në formë verbale p.sh. gjatë parashtrimeve, shpjegimeve me gojë nga palët ose me çdo akt procedural të shkruar nga pala: si kërkesë padia, prapësimet me shkrim, kundërpadia etj.
- b. Pohimi i nxitur gjyqësor. Kemi në ato raste kur njëra palë i bën pyetje palës tjetër për pranimin ose jo prej saj të një fakti të çështjes duke pritur përgjigje pohuese ose mohuese për të.

*Dallimi ndërmjet "pohimit gjyqësor" dhe "shpjegimeve të palës në procesin gjyqësor" lidhet me qëllimin që ndiqet në rastet e analizuar.*

*Nëse pohimi gjyqësor synon provueshmërinë e vërtetësisë së një fakti të caktuar, shpjegimet e palës kanë synim më të gjërë, të analizojë vërtetësinë e fakteve të pretenduara për t'u provuar si dhe të analizojë pasojat ligjore të fakteve të vërtetuara.*

*Nëse pohimi gjyqësor ka karakter vetëm deklarativ për vërtetësinë e një fakti, shpjegimet e palës kanë më shumë karakter interpretative dhe sqarues.*

10 pikë

*Vangjel*

3. -a-Jepni përcaktimin ( përkufizimin) se çfarë quhen “prezumime” në procesin gjyqësor civil si dhe tregoni sa lloj prezumimesh kemi?

*Prezumime, quhen pasojat që ligji dhe gjyqtari nxjerrin prej një fakti të ditur për të përcaktuar një fakt të paditur.*

*Prezumimet janë:*

- *Prezumime ligjore, të cilat mund të jenë:*
  - a. *Prezumime ligjore absolute*
  - b. *Prezumime ligjore relative: p.sh. prezumimet e atësisë së fëmijës të lindur gjatë martesës ose brenda 300 ditëve nga zgjidhja e martesës; prezumimi i mirbesimit në posedim.*
- *Prezumime fakti, të cilat janë ato që përcaktohen nga gjykata bazuar në faktet dhe provat e çështjes si dhe në bindjen e brendshme të gjyqtarit.*

5 pikë

- b-Cila është rëndësia e pranimit të një prezumimi në raport me faktet e tjera objekt gjykimi në një procesin gjyqësor?

*Pranimi i një prezumimi në raport me faktet e tjera objekt gjykimi në një procesin gjyqësor i jep një status të veçantë një fakti në proces pasi ai konsiderohet i vërtetë deri sa të provohet ndryshe. Pranimi i prezumimit ndikon në përcaktimin e barrës së provës, bën më efektiv procesin gjyqësor në pikpamje të kohëzgjatjes dhe thjeshtëm të procesit si dhe ndikon në parashikueshmërinë e funksionimit të gjykatës në misionin e saj për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve civile.*

7 pikë

4. -a- A mundet gjykata kryesisht të bëjë cilësimin e fakteve dhe veprimeve, që lidhen me mosmarrëveshjen në mënyrë të ndryshme nga ai që kanë propozuar palët?

*Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normal e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj. Ajo bën një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët. ( neni 16)*

6 pikë

- b- A mundet gjykata kryesisht ta cilësojë padinë e paditësit nga padi për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë ( nenet 296/301 i Kodit Civil) në padi, që rrjedh nga detyrimet e lindura nga kontrata e qirasë, kur gjatë gjykimit provohet se padia e paditësit nuk është padi rivendikimi, por padi që rrjedh nga kontrata e qirasë? Përgjigju me po ose jo dhe arsyeto shkurt përgjigjen.

*Përgjigja është “JO” dhe lidhet me raportin e parimeve të “disponibilitetit” dhe “oficialitetit” në gjykimin civil, pra lidhur me raportin e gjykatës dhe palëve në procesin gjyqësor civil.*

*Kodi Procedurës Civile ka dispozita që e rregullojnë këtë raport.*

*Vishaj*



Sqarimi më i plotë i këtij raporti është trajtuar në Vendimin Unifikues nr. 3, datë 29.03.2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Sipas këtij Vendimi;

Gjykata, nuk ka të drejtë të ndihmojë aktivisht palët në formulimin e kërtimeve të tyre. Kjo është përgjegjësi e palëve, të cilat janë të lira të ndërtojnë mbrojtjen e interesave të tyre në gjykim, nëpërmjet përfaqësimit ose të çdo ndihme tjetër juridike, në përputhje me dispozitat në fuqi (neni 23 i K.Pr.Civile).

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se gjykata ka detyrimin që t'i përmbahet objektit të padisë të parashtruar nga paditësi dhe të mos shprehet për pranimin ose rrëzimin e asaj që nuk është kërkuar në kërkesëpadi, përveç kur ligji parashikon të kundërtën. Kjo do të thotë se është paditësi ai që i kërkon gjykatës zgjidhjen e një mosmarrëveshje të caktuar, duke parashtruar kërtime konkrete, të cilat në tërësinë e tyre formojnë objektin e mosmarrëveshjes.

Parimi i përputhjes midis asaj që kërkohet dhe asaj për të cilën shprehet gjykata është parim bazë i së drejtës procedurale civile, pasi nuk mund të ketë ultra petita partium.

Nga ana tjetër, gjykata nuk është e detyruar dhe e lidhur me cilësimin juridik që paditësi i bën mosmarrëveshjes, por duke qenë se e njëj vetë ligjin, bën cilësimin që ajo çmon për rastin konkret dhe jep zgjidhjen bazuar në bindjen e saj të brendshme, të formuar nga gjykimi i çështjes konform ligjit, duke i gjetur të bazuara apo jo pretendimet e parashtruara në padi.

Gjykata nuk e shkel parimin e përputhjes midis asaj që kërkohet dhe asaj që jepet, nëse bën një cilësim të ndryshëm juridik të fakteve të çështjes.

Por, nëse, cilësimi juridik që gjykata u bën fakteve të çështjes, ndryshon nga shkaku i padisë i përcaktuar në kërkesëpadi, gjykata nuk mund të anashkalojë një fakt të tillë dhe në këtë rast, nuk mund t'a ndryshojë atë (shkakun e padisë) me nisiativën e saj.

10 pikë

#### Konkluzioni:

Gjykata nuk mund të ndryshojë shkaku e padisë të përcaktuar nga paditësi, i parë në lidhje të ngushtë me objektin e padisë, dhe të shprehet për diçka që nuk i është kërkuar (p.sh nga padi rivendikimi që ka paraqitur paditësi, gjykata të shprehet për padi që rrjedh nga kontrata e qirasë).

#### Shënim:

Në vlerësimin për pyetjet joriprodhuese kanë vlerë për vlerësimin;

Struktura / rrjedhshmëria, Argumentimi, Konkluzioni



## TESTI PROFESIONAL

### E DREJTA FAMILJARE

#### Rubrika I: Pyetje mbi koncepte (8 pikë)

1. A ka të drejtë bashkëshorti të kërkojë kontribut kompensues në rastin e zgjidhjes së martesës nëse ata kanë zgjedhur si regjim pasuror atë të pasurive të ndara? Sa ndikon regjimi në pasojat e zgjidhjes së martesës?

#### Përgjigje

*Bashkëshortët gjatë martesës dhe në mbarim të saj përmes zgjidhjes nuk mund t'i shmangen të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin për ta nga martesë cilldo ka qenë regjimi pasuror martesor që 'ka qeverisur' martesën e tyre. Pra, cilldo regjim i zgjedhur, pavarësisht veçorive që ka, nuk efektikon të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga martesë.*

*Kontributi kompensues, si një nga pasojat fakultative të zgjidhjes së martesës hyn tek ato të drejta të cilat nëse janë kushtet, mund të kërkohej nga njëri bashkëshort, është në diskrecion të gjykatës të vlerësojnë nëse mund të detyrojnë ose jo njërin nga ish-bashkëshortët të derdhë për llogari të tjetrit një kontribut e kërkuar. Ky kontribut është i destinuar për të kompensuar sa të jetë e mundur pabarazinë që mund të shkaktojë në jetën e tjetrit ndarja e pasurisë në zgjidhjen e martesës.*

*Lidhur me këtë pasojë të zgjidhjes së martesës, legjislatori, me të drejtë nuk bën asnjë dallim varësisht regjimit pasuror martesor dhe kështu bëhet e qartë se regjimi i pasurive të ndara nuk cenon asnjë pasojë të zgjidhjes së martesës që nuk lidhet me pjesëtimin e pasurive.*

#### Rubrika II Pyetje krahasuese (12 pikë)

1. Si do ta vlerësonit marrëveshjen e lidhur midis bashkëjetuesve heteroseksualë sipas nenit 164 të Kodit të Familjes, nëse njëri prej tyre rezulton i martuar përgjatë gjithë kohëzgjatjes së bashkëjetesës? Po marrëveshjen e lidhur midis bashkëjetuesve homoseksualë?

Neni 164

*Personat bashkëjetues mund të lidhin marrëveshje para noterit, ku përcaktojnë pasojat që rrjedhin nga bashkëjetesa lidhur me fëmijët dhe pasurinë gjatë bashkëjetesës.*

#### Përgjigje

*Kodi i Familjes së RSH-së njeht parimin e monogamisë (një burrë dhe një grua) dhe të heteroseksualitetit (burrë dhe grua) si për martesën ashtu edhe për bashkëjetesë. (Martesa mund të lidhet ndërmjet një burri dhe një gruaje që kanë mbushur moshën 18 vjeç – neni 7 i KF-së; bashkëjetesa është një bashkim fakti midis burrit dhe gruas që jetojnë në çift – neni 163 i KF-së).*

*Pra, ashtu sikurse nuk mund të ketë dy martesë në të njëjtën kohë, e njëjta vlen edhe për bashkëjetesën dhe përzjerjen e martesës me bashkëjetesën. Sipas këtyre parimeve, nëse njëri nga bashkëjetuesit heteroseksualë rezulton se është i martuar përgjatë gjithë kohëzgjatjes së bashkëjetesës, marrëveshja e*

*Ylona Louina*

*bashkëjetuesve e lidhur para noterit për pasojat që rrjedhin nga bashkëjetesa është e pavlefshme. Sa i përket fëmijëve të lindur nga bashkëjetesa, ata do të gëzojnë të njëjtat të drejta si fëmijët e lindur nga martesë.*

*Legjislacioni shqiptar nuk e njeh as martesën dhe as bashkëjetesën mes personave të së njëjtës gjini ndaj edhe çdo marrëveshje e lidhur para noterit për pasojat që rrjedhin nga këto bashkëjetesa është e pavlefshme.*

### **Rubrika III: Pyetje argumentuese (15 pikë)**

1. A mundet gjykata të caktojë detyrim për ushqim në ngarkim të një prindi, i cili si të ardhur të vetme ka një pension invaliditeti apo ndihmë tjetër ekonomike? Çfarë zgjidhjesh ka me qëllim respektimin e parimit mbi interesin e fëmijës?

#### **Përgjigje**

*Kodi i Familjes përcakton subjektet e detyruara lidhur me detyrimin për ushqim si edhe radhën e tyre. Nëse subjektet e një radhe më të afërt janë në pamundësi për të përmbushur detyrimin ushqimor, ky detyrim i kalon subjekteve në radhët pasardhëse. Pra, nëse personat e ngarkuar për dhënien e detyrimit për ushqim nuk janë në gjendje që ta japin këtë tërësisht ose pjesërisht, ky detyrim u kalon tërësisht ose pjesërisht personave që janë në radhë të mëpasme.*

*Detyrimi për ushqim caktohet në raport me nevojat e atij që e kërkon dhe mundësitë ekonomike të atij që detyrohet. Sipas rastit, gjykata është ajo që vlerëson nëse të ardhurat nga pensioni i invaliditetit, apo ndihma ekonomike mund të mbulojnë sado pak ose jo detyrimin ushqimor dhe pas kësaj vlerësimi siguron që detyrimin ushqimor të kalojë në radhët e tjera të subjekteve që kanë detyrim.*

### **Rubrika IV Arsytim analitik (15 pikë)**

1. Neni 197 i Kodit të Familjes paraqet qortë detyrimin për ushqim vazhdon edhe për kohën që fëmijët madhorë ndjekin shkollën e mesme ose të lartë, deri në moshën 25 vjeç. A legjitimohet prindi të kërkojë detyrimin ushqimor për fëmijën madhor, në procesin për zgjidhjen e martesës dhe pasojave të saj? Si do të veprojë gjykata në një rast të tillë? Po nëse fëmija bëhet madhor pas zgjidhjes së martesës a mund të kërkojë vazhdimin e detyrimit për ushqim për shkak të ndjekjes së shkollës? Nga ku?

#### **Përgjigje**

*Sipas rastit të paraqitur kemi dy situata.*

*Situata e parë, fëmija është madhor gjatë procedurës së zgjidhjes së martesës së prindërve. Si i tillë, ka dalë nga përgjegjësia prindërore por ka të drejtën e detyrimit ushqimor deri në moshën 25 vjeç sepse ndjek shkollën. Në këtë rast, nëse fëmija është madhor gjatë zgjidhjes së martesës Gjykata mund të orientojë palët që vetë fëmija madhor legjitimohet të kërkojë me padi më vete detyrimin për ushqim ndaj prindërve nëse plotësohen kriteret e nenit 197 të Kodit të Familjes. Pra, të vërtetojë që ndjek shkollën e mesme ose të lartë dhe se është nën moshën 25 vjeç.*

*Situata e dytë, fëmija mbush moshën madhor pas zgjidhjes së martesës së prindërve. Fëmija ka të drejtën e vazhdimin të detyrimit ushqimor deri në moshën 25 vjeç sepse ndjek shkollën. Në këtë rast, vetë fëmija madhor mund të kërkojë vazhdimin e detyrimit për ushqim për shkak të ndjekjes së shkollës, deri në moshën 25 vjeç.*

*Vjosa Louisi*